



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 88
Prishtinë, më 24.6.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Doarsa Kica-Xhelili, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

Munguan: Xhavit Haliti, Fitore Pacolli-Dalipi dhe Ariana Musliu-Shoshi.

Pjesëmarrës të tjerë: Alisa Thaçi, Kuvend; Drin Podrimqaku, GP-LVV; Liridona Gashi, Kabinet Kuvend; Leudita Mejzini, Adriana Osmani, Albana Bucaliu, Kuvend.

Nga Zyra e Komisionit: Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29 prill, 21, 22 maj dhe 6 qershor 2024;
3. Lejimi i shpenzimeve për organizimin e Pritjes për përfituesit e Programit për Diplomaci Qytetare nga MPJD;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi rendin e ditës;

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29 prill, 21, 22 maj dhe 6 qershor 2024;

Kryetarja konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 29 prill, 21, 22 maj dhe 6 qershor 2024;

3. Lejimi i shpenzimeve për organizimin e Pritjes për përfituesit e Programit për Diplomaci Qytetare nga MPJD-ja;

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, njoftoi se në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është lansuar Programi për Diplomaci Qytetare, qëllimi i të cilit është përfshirja e mërgatës në institucionet e Kosovës. Ky program, tha se që dy herë është duke u realizuar dhe është menduar që komisioni t'i takojë anëtarët e këtij programi, të cilët janë të rinj që vijnë nga diaspora. Bëri të ditur se është menduar që të bëhet një pritje, një lloj kokteji, ku mund të bashkëbisedohet me ta për çështje të ndryshme e që mund të jenë të rëndësishme.

Time Kadrijaj, tha se do të kishte qenë mirë që deputetët ta kenë listën e përfituesve të këtij programi. Tha se është për qasjen e diasporës në institucionet e Kosovës, por se kur është shpërndarë rendi i ditës, është dashur të shpërndahet edhe lista e përfituesve të këtij programi.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, tha se lista e përfituesve është online, dhe se secili mund ta shoh atë listë.

Pas diskutimeve, kryetarja e komisionit e hodhi në votim lejimin e mbulimit të shpenzimeve nga buxheti i komisionit me rastin e organizimit të pritjes për përfituesit e Programit të Diplomacisë Qytetare nga MPJD-ja.

Në procesin e votimit, morën pjesë pesë (5) anëtarë të komisionit.

Në mungesë të kuorumit të nevojshëm për punë, për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati vendimmarrje nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

Kryetare e Komisionit